DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

BULETINI INFORMATIV

TETOR 2022

# Vizitë e Ministrit të Drejtësisë në ambientet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

**Gjatë vizitës së Ministrit të Drejtëssë në Drejtori u diskutuan arritjet dhe sfidat që paraqet sistemi ofrimit të shërbimit juridik dhe jo vetëm .**

**Do të hapim Qendra të reja të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore sipas hartës së re gjyqësore, në kuadër dhe të zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 495 datë 21.07.2022 "Për Riorganizimin e Rretheve Gjyqësore dhe Kompetencave Tokësore të Gjykatave". Këto qendra do të financohen nga buxheti i shtetit për vitin 2023.**

**U zhvillua takimi mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me avokatët ofrues të këtij shërbimi në qytetet e Elbasanit, Pogradecit dhe Korçës.**

**Në bazë të nenit 9 shkronja d) të ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" Dhoma Kombëtare e Avokatisë përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.**

**U zhvillua trajnimi mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti për avokatët ofrues të këtij shërbimi pranë Dhomave Vendore të Avokatisë Elbasan, Pogradec dhe Korçë. Ky trajnim u zhvillua nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë në kuadër të Projektit "Fuqizimi i profesionalizmit të avokatëve në përfaqësimin dhe mbrojtjen e kategorive vulnerabël, përfituese të ndihmës juridike, me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor në proceset civile dhe penale", mbështetur nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) si pjesë e projektit "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" EFLAS që zbatohet nga PNUD në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë me mbeshtetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).**

.

**Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, z. Qirici krahas vlerësimit të bashkëpunimit me aktorët kyç të ndihmës juridike falas dhe arritjeve që nga fillimi i funksionimit të sistemit, ndau disa nga problematikat kryesore të evidentuara në praktikë.**
**Në fund të fjalës së tij, Drejtori i Përgjithshëm shprehu gadishmërinë e plotë të tij dhe stafit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në angazhimin maksimal në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me të gjithë aktorët, Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë, Ministrinë e Drejtësisë me qëllim ofrimin e një shërbimi ligjor sa më cilësor, efiçent dhe profesional**

**Më datë 06.10.2022, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec në bashkëpunim me Shoqatën "Unë Gruaja" dhe me mbështetjen e përfaqësueses së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, zj. Klejda Poçi, zhvilluan një takim informues në shkollën 9 vjeçare "Servet Agolli".**

**Ky takim shërbeu për të folur nga afër për sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti me stafin pedagogjik të kësaj shkolle, prindër të nxënësve të ftuar dhe nxënës të shkollës.**

**Ky takim pati në fokus viktimat e mitur, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit.**

**Nxënësit e shkollës kishin përgatitur gjithashtu disa piktura kundër trafikimit, në kuadër të aktiviteteve të muajit Tetor anti trafik.**

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Parësore Lushnje në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Social pranë Bashkisë Lushnje, e veçanërisht me specialistët e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve organizoi një aktivitet me nxënësit e shkollës 9-vjecare "Katër Dëshmoret" Lushnje. Takimi u zhvillua në mjediset e shkollës me pjesëmarrjen e nxënësve të klasave të shtata e të teta, në prani edhe të psikologes së shkollës.
U zhvillua një komunikim të drejtpërdrejtë me nxënësit të cilët e kishin konceptin e trafikimit, kishin dëgjuar për të dhe folën për informacionin që kishin. Biseda u thellua duke ju folur për rrezikun që paraqet për ta dhe se duhet të dinë si të veprojnë për ta evituar.
Gjatë këtij diskutimi nxënësit patën mundësi të njihen me rolin e ligjit per ndihmën juridike falas, si të mitur bëjnë pjesë në kategoritë e veçanta përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

**Interesante ishin vizatimet që nxënësit e shkollës kishin punuar me temë "Jo trafikimit"**

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier organizoi me datë 07.10.2022 pranë Shkollës së Mesme "Zhani Ciko" një takim sensibilizues me temë "Trafikimi i qënieve njerëzore" në bashkëpunim me Sherbimin Social Bashkia Patos, Shërbimi Psiko-social i Shkollës, KMD, stafi Petagogjik i shkollës si dhe me pjesëmarrjen e Suela Fetahu, paraligjore pranë DNJF. Ky takim u shfrytëzua për tu njohur me ligjin 111/2017, konkretisht me kategroinë e vecantë "viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal", ku konsiston ndihma juridike falas, shërbimet që ofrohen dhe vendodhjen e re të qendrës. Gjatë takimit u dakordësua me stafin petagogjik që të adresonin pranë qendrës rastet që do evidentonin, gjithashu u shpërndanë edhe fletpalosje në kuadër të informimit.

MOS HESHT
STOP TRAFIKIMIT TË NËRZVE
END HUMAN TRAFFICKING

PLEASE DON'T HURT ME!
Stop
I AM NOT FOR SALE
STOP TRAFIKIMIT TË NËRZVE
END HUMAN TRAFFICKING
NOT FOR SALE
MOS HESHT

**Më datë 06.10.2022 në kuadër të promovimit me pjesëmarrjen e paraligjores se Drejtorisë se Ndihmes Juridike Falas u realizua një takim me Drejtoreshën e Postës Fier. Zhvilluam një prezantim për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas si dhe kërkuam bashkëpunimin e saj për të lënë fletëpalosjet pranë sporteleve të postës Fier dhe për të vendosur në ambientet e postës posterat, duke qënë se është ambjent shumë i frekuentuar nga një numër shumë i lartë njerëzish. Më pas zhvilluam një prezantim në terren para Postës si dhe tek Sheshi para Xhamisë. Konstatuam disa raste problematikash për pronësi dhe për rillogaritje me pensionet.**

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Berat organizoi në datë 07.10.2022 pranë Qendrës Multifunksionale Rinore  një takim sensibilizues me teme “Trafikimi i qenieve njerëzore”  në bashkëpunim me Shërbimin Social Bashkia Berat, si dhe në bashkëpunim me Znj Erinalda Spahiu Ndihmëse specialiste per edukimin në shkolla nga Drejtoria Vendore e Policise Berat  si dhe me pjesëmarrjen e nje grupi nxënësve përfaqësues nga dy shkolla te mesme "Shkolla Shyqyri Lakra "Berat dhe Shkolla e përgjithshme Elbasan.

Takimi u shfrytëzua për tu njohur me ligjin 111/2017, konkretisht me kategorinë e vecantë “viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal”, ku konsiston ndihma juridike falas, shërbimet që ofrohen,si mund të asistohen nga Qendra dhe vendodhjen e  qendrës.

NIKE

Më datë 11.10.2022 Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lushnje me mbështetjen e zj. Klejda Poçi, përfaqësuese e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe në bashkëpunim në bashkëpunim me njësinë e mbrojtjes së fëmijëve dhe Drejtorinë e Shërbimit Social pranë Bashkisë Lushnje zhvilluan një fushatë ndërgjegjësimi në shkollën "Foto Puka". Kjo vizitë në shkollë shërbeu për të diskutuar me nxënësit rreth sistemit të ndihmës juridike, të drejtat që u jep ligji nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" të miturve në konflikt me ligjin. Gjatë bashkëbisedimit me stafin pedagogjik u ndanë eksperienca të qytetarëve viktima të dhunës në familje dhe viktimave të mundshme të trafikimit të cilat u referuan si raste konkrete pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lushnje.

Në kuadër të aktiviteteve të muajit Tetor, si muaji i ndërgjegjësimit të Viktimave të Dhunës në Familje, abuzimit seksual dhe trafikimit më datë 12.10.2022 Qendra e Shërbimit Juridik Parësore Elbasan në bashkëpunim me përfaqësuesen e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas Znj. Suela Qevani dhe Paraligjoren Znj. Suela Fetau zhvilloi një takim pranë Fondacionit "Joscelyn". Drejtuesi i fondacionit shprehu gatishmërinë për realizimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi në kuadër të referimit të rasteve. Gjithashtu u mundësua një takim në qendrën "Tradita ime artizanale", e cila eshtë një nismë e fondacionit "Joscelyn " e cila mbështet gratë dhe vajzat vulnerabël duke ofruar një strehë sociale dhe punësim për to.

**Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan në bashkëpunim me paraligjoren Znj. Suela Fetau realizuan një takim me drejtoreshën e shkollës profesionale "Ali Myftiu" Elbasan, dhe zhvilluam një fushatë ndërgjegjësimi me klasat e 12-ta dhe 13- ta të kësaj shkolle. Ky takim u shfrytëzua për bërë njohjen e nxënësve me ligjin 111/2017, konkretisht me kategorinë e vecantë "viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal", ku konsiston ndihma juridike falas, shërbimet që ofrohen dhe vendodhjen e qendrës. Në klasat ku u bë senzibilizimi u bë dhe shpërndarja e fletëpalosjeve.**

**Në bazë të marrvëshjes së mirëkuptimit nr. 1103 datë 09.05.2022, ndërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Qendrës Psiko – Sociale "Vatra", Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë zhvilloi një sesion informues dhe ndërgjegjësues gjatë të cilit nxënës të shkollës "Avni Rustemi" u sensibilizuan mbi fenomenin e dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Gjatë takimit u vu theksi mbi informimin ligjor të nxënësve lidhur me menyrat e raportimit dhe adresimit për te reduktuar fenomene të tilla. Gjithashtu bem të mundur dhe informimin mbi shërbimin ligjor falas dhe sherbimet e ndihmës juridike parësore dhe dytësore që oforn Qendra, për viktimat e dhunës në familje, viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.**



Në kuadër të aktiviteteve ndërgjegjësuese të Qendrës të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Berat për muajin Tetor 2022, Qëndra organizoi më date 13.10.2022 një takim sensibilizues me temë “Viktimat e dhunës ne familje,” në bashkëpunim me Sherbimin Social Bashkia Berat, me pjesmarrjen e disa zonjave viktima të dhunës ,si dhe me pjesmarrjen e perfaqësueses nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas Znj Klejda Poci . Takimi u shfrytëzua për t'u njohur me ligjin nr.111/2017, konkretisht me kategorinë e vecantë “viktimave të dhunës”, ku konsiston ndihma juridike falas, shërbimet që ofrohen dhe referimin e tyre pranë Qendrës.
U identifikuan rastet dhe u mbajtën shënim për tu kontaktuar.

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë zhvilloi një takim në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare Pritëse të Trafikimit në Linzë në kontakt me përgjegjësen e shërbimit social zj. Elona Katana, me pjesëmarrjen e Zj.Suela Qevani përfaqësuese e DNJF si dhe paraligjorja Zj.Suela Fetau.
Gjatë këtij aktiviteti u trajtuan raste të ndryshme të problematikave të grave apo vajzave ku përveç përvec informimit mbi shërbimet e ndihmës juridike falas, si kategori e menjëhershme përfituese referuar ligjit nr 111/2017 "Për Ndihmën juridike të Garantuar nga Shteti", trajtuam dhe çështje të ndryshme të tyre duke i konsistuar në këshillime ligjore apo përfituese të ndihmës juridike dytësore me objekt zgjidhje martese , kundërshtim atësie etj.



**Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë zhvilloi një takim më datë 17.10.2022 në bashkëpunim me Qendrën Psiko – Sociale "Vatra", me pjesëmarrjen e Znj. Irma Alushaj përfaqësuese e DNJF.**
**Gjatë këtij aktiviteti të zhvilluar në ambientet e "Strehëzës", e cila ofron akomodim, rehabilitim dhe shërbime riintegruese për viktima shqiptare dhe të huaja të trafikimit njerëzor, u trajtuan problematika të natyrave të ndryshme të grave dhe vajzave si dhe u informuan mbi shërbimet e ndihmës juridike falas, si kategori e vecantë përfituese referuar ligjit nr 111/2017 "Për Ndihmën juridike të Garantuar nga Shteti".**

**Në kuadër të promivimit të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier, me datë 18.10.2022 u zhvillua një aktivitet pranë shkollës 9-vjecare "Meleq Gosnishti" Patos me përfaqësues të Stafit Petagogjik, Psiko-social të shkollës, përfaqësues të Drejtorisë e Shërbimit dhe Kujdesit Social Patos si dhe me pjesëmarrjen e përfaqësueses së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas znj. Irma Alushaj.**
**Ky takim u shfrytëzua për tu njohur me ligjin 111/2017, konkretisht me kategorinë e vecantë "viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal", ku konsiston ndihma juridike falas, shërbimet që ofrohen dhe vendodhjen e re të qendrës. Gjatë takimit u dakordësua me stafin petagogjik për bashkëpunime të tjera në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit nëpërmjet aktiviteteve në vazhdim.**

# 18 Tetori Dita Europiane Kundër Trafikimit të Personave.

**Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të komunitetit, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë, ju bashkua thirrjes së bërë nga Qendra "Vatra" në bashkëpunim më Komisariatin e Policisë Vlorë, partnerë të tjerë lokal si edhe organizata të shoqërisë civile, në marshimin përgjatë Bulevardit Vlorë-Skelë.**
**Marshuam nën logon "Bashkë Mundemi", për një shoqëri pa dhunë, shfrytëzim dhe diskriminim.**

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec mori pjesë në trajnimin e organizuar nga shoqata 'Unë Gruaja' me temë "Rritja e informacionit,ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor për të drejtat e njeriut,ndihmë juridike falas dhe akses i përmirësuar në shërbimet e ndihmës juridike falas për njerëzit në nevojë e shtesat e margjinalizuara". Në takim morën pjesë kordinatorë kundër dhunës në familje, njesitë e mbrojtjes së fëmijëve,sektorit të barazizë gjinore dhe psikologë të shkollave nga bashkitë Pogradec dhe Korçë. Në takim u ra parimisht dakord për ngritjen e një grupi të përbashkët pune me qëllim informimin e qytetarëve mbi ligjin 111/2017.

**Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan së bashku me paraligjoren Suela Fetau zhvilloi një aktivitet  pranë shoqatës " Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome" në qytetin e Elbasanit.**

**Takimi u realizua në zyrën e shoqatës me kryetarin e shoqatës Z. Elvis. Gjatë takimit u informuan mbi ligjin nr. 111/ 2017, katrgoritë përfituese të ligjit, u informuan mbi vendndodhjen e QSHNJP Elbasan në këtë qytet. U konkordua për bashkëpunim dhe për referim të rasteve pranë QNJP Elbasan.**

Gjatë takimit informuam dhe disa nga qytetarët e komunitetit Romë dhe Egjiptian që ishin n ambjentet e shoqatës, u evidentuar rastet problematike, disa u këshilluan në moment dhe pjesa tjetër do paraqiten në ditët në vazhdim pranë qëndrës.

Takimi ishte frytëdhënës pasi u konkordua për bashkëpunim me shoqatën, si dhe u bë informimi i njerëzve të komunitetit romë dhe egjiptian si dhe u evidentuan rastet problematike, pasi shoqata ishte shumë e frekuentuar nga popullsia rome/ egjiptiane. Si nga kryetari i shoqatës dhe nga pjesmarrësit e tjerë u vlerësuan dhënien e informacionit mbi DNJ dhe vendodhjen e QSHNJP Elbasan.

**Më datë 25.10.2022 juristet e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore morën pjesë në një takim që Njesia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Lezhë zhvilloi në 2 klasa të shkollës 9-vjecare të shkollës "Besëlidhja" ku mendohej nga punonjëset sociale dhe psikologët e kësaj njësie që në këto 2 klasa kishte 2 vajza të cilat mund të ishin viktima të mundshme trafikimi.**

**Gjatë takimit që zgjati 45 min me secilën klasë u diskutua rreth trafikimit dhe rrezikut që i kanoset këtyre fëmijëve duke u shoqëruar me njerëz më të mëdhenj në moshë.**

**Në kuadër të promovimit të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër dhe muajit të ndërgjegjësimit të viktimave të dhunës në familje/abuzimit seksual dhe trafikimit u zhvillua aktiviteti ndërgjegjësues pranë Shoqatës "Gruaja te Gruaja", me përfaqësuesen e tyre Blerta Nurja dhe Menaxheren e Strehëzës Silvana Makaj etj.**

**Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas z. Ilberjan Durmishi, në ambjentet e OJF-së e cila në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër menaxhon Strehëzën emergjente deri në dhënien e Urdhrit të Menjehershëm të Mbrojtjes.**

**Në këtë takim u bë prezantimi i ligjit 111/2017 dhe kategorive përfituese, shërbimet që ofrohen për individët dhe komunitetet në nevojë, ku u trajtuan dhe raste konkrete mbi problematikat e evidentuara, ku në fokus kanë qenë kategoritë e veçanta viktima të dhunës në familje/abuzimit seksual dhe trafikimit.**



**Në kuadër të promovimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, u zhvillua nga paraligjorja një takim në Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencave, Komuniteti Rom Tufinë.**

**Aktiviteti u zhvillua fillimisht me Drejtoreshën dhe me stafin e qendrës. U informuan mbi ndihmën juridike, kategoritë përfituese, ku mund të merret shërbimi, si dhe vendodhjen e QSHNJP në Tiranë. Drejtoresha e Qendrës shprehu gadishmërinë për bashkëpunim, pasi qendra është pritëse për gati 50 familje të komunitetit rom.**

**Më pas u zhvillua një takim me pjestarët e komunitetit rom që jetojnë në qendër.**

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë në bashkëpunim me Fondacionin Mary Ëard Loreto Rrëshen dhe me mbështetjen e përfaqësuesit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas z. Iblerjan Durmishi, organizoi një takim me disa nga institucione të këtij qyteti. Institucionet pjesëmarrëse u shprehën shume të interesuar për Qendrën dhe ligjin për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti. Ramë dakort për të organizuar edhe takime të mëtejshme me prindër dhe nxënës me disa nga psikologët e shkollave si edhe me Drejtorinë e Shërbimit Social të Bashkisë Mirditë për të vijuar me promovimin e qendrës në këtë qytet.

**Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Luftës Kundër Trafikimit, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social me anë të se cilit përmbylli aktivitetete e zhvilluara gjatë këtij muaji antitrafik duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit mbi trafikimin, si dhe promovimin e përpjekjeve që kemi ndërmarrë vazhdimisht me tryezën antitrafik.**

**Sot në këtë takim përmbyllës për Lezhën u ndalëm pranë shkollës "At Shtjefen Gjeçovi" ku nxënësit të kësaj shkolle dhanë shumë mesazhe sensibilizuese ndaj luftës antitrafik.**

**Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Dibër në bashkëpunim me përfaqësues të shkollës së mesme "Said Neideni", përfaqësuesin e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës të Bashkisë Dibër, mbështetur nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas z.Ilberjan Durmishi zhvilluan një sesion informues dhe ndërgjegjësues  të nxënësve dhe mësuesve lidhur me shkaqet dhe pasojat e dhunës në familje dhe trafikimit.**

**Gjatë takimit, ju kërkua përfaqësuesve të referojne pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Diber rastet për ndihmë juridike parësore.**

**Gjatë këtij takimi u shpëndanë edhe fletepalosje informuese mbi ndihmën juridike mësuesve dhe nxënësve të shkollës.**

**Takim në shkollën 17 Shkurti Qesarakë, organizuar nga paraligjorja e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.**

**Ky takim u shfrytëzua për tu njohur me ligjin 111/2017, konkretisht me kategrorinë e vecantë "viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal", ku konsiston ndihma juridike falas, shërbimet që ofrohen dhe vendodhjen e Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore Tiranë.**

**Gjate takimit u dakordësua me stafin pedagogjik për bashkëpunime te tjera, si dhe për evidentime të rasteve së bashku dhe me punonjësen sociale dhe psikologun e shkollës.**

**Qendra e Shërbimit të Ndihms Juridike Parësore Shkodër mori pjesë në aktivitetin ndërgjegjësues me temë: "Edukimi ligjor-mjet për rritjen e aksesit të qytetarëve të Shkodrës, në mënyrë të veçantë të grupeve në nevojë në sistemin e drejtësisë" organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. Pjesëmarrës në këtë takim ishin gjithashtu avokati mentorues i Qendrës se Shërbimit te Ndihmës Juridike Parësore Shkodër, përfaqësues të OJF që operojnë në qytet dhe studentët e Fakultetit të Drejtësisë.**
**Nga ana e punonjësve të qendres u bë një njohje me ligjin nr.111/2017 " Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti ", aspekte praktike të zbatimit të tij, subjektet përfituese të ndihmës juridike, dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e ndihmës juridike dytësore falas.**

**Në kuadër të promovimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas u zhvillua takim n Qendrën Polivalente Ditore Kamëz.**
**Kjo qëndër mirëpret çdo ditë rreth 30 të moshuar të zonës së Kamzës.**

**Ky aktivitet ndërgjegjësues kishte në fokus grupmoshën e tretë, të moshuarit që jan me të ardhura të ulta dhe që i përkasin kategorisë së vecantë, si dhe përfitues t pensionit për shkak të aftësisë së kufizuar.**

**Gjatë diskutimit me të moshuarit u bë evidentimi i rasteve që kishin nevojë pë ndihmë juridike.**



**Në kuadër të promovimit të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër dhe të muajit të ndërgjegjësimit të viktimave të dhunes në familje/abuzimit seksual dhe trafikimit.**
**u zhvillua takimi pranë Shoqatës Komuniteti Papa Xhovani i XXII.**
**Në këtë takim u bë prezantimi i ligjit 111/2017 dhe kategorive përfituese, shërbimet që ofrohen për individët në nevojë, ku u trajtuan dhe raste konkrete mbi problematikat e evidentuara.**

**Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë në kuadër të muajit antitrafik ka zhvilluar një takim me prindër dhe fëmijë me të cilët u diskutua rreth rrezikut të trafikimit të qënieve njerëzore.**

**Në kuadër të promovimit të ndihmës juridike falas pranë shtresave në nevojë, zhvilluar fushatë ndërgjegjësimi pranë pranë komunitetit romë "Bregu Lumit", Allias Tiranë.**

**Në mjediset e Pallatit të Kulturës Durrës u zhvillua një vizitë e një grupi gazetarësh nga Austria.**
**Grupi i gazetarëve u njoh me 2 projektet e mbështetura nga UNDP/ADA të lidhura me ndihmën ligjore falas dhe ndërmjetësimin, për të cilat u bënë edhe prezantimet përkatëse.**
**Takimi vijoi me një vizitë në Qendren e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Durrës dhe Zyrën e Ndërmjetësimit ku u bë një prezantim i shkurtër i Qendrës.**




Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjirokastër organizoi një aktivitet pranë Qendrës të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, (Qendra e Emergjencës Gjirokastër).
Aktiviteti u organizua nga juristët e Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike parësore Gjirokastër.
Pjesmarrës në aktivitet: AV. Elona Frëngu (avokate e ndihmës juridike dytësore), përfaqësues të Qendrës së trajtimit të rasteve të dhunës në familje si dhe kategori të veçanta, zonja viktimë dhune.
Aktiviteti konsistojë në informimin mbi ligjin për dhunën në familje, si dhe ligjin 111/2017 "Për ndihmën Juridike të garantuar nga shteti".
U krijua bashkëbisedim me zonjat pjesmarrëse, mbi mundësitë që kanë për të përfituar avokat falas, përjashtim nga kostot dhe shpenzime gjyqësore, konsulenc juridike, asistencë në mbledhje dokumentacioni.
U informuan mbi të drejtën për shtyrje të urdhërit të mbrojtjes, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, pension ushqimor, si dhe ndihmë ekonomike.

Në kuadër të aktiviteteve të muajit Tetor, si muaji i ndërgjegjësimit të Viktimave të Dhunës në Familje, abuzimit seksual dhe trafikimit, Qendra e Shërbimit të Ndihmë Juridike Parësore Durrës, me pjesëmarrjen e përfaqësueses së Drejtorisë së Ndihmë Juridike Falas Tiranë, Znj. Suela Qevani dhe Paraligjoren Znj. Suela Fetau, zhvilloi nje takim pranë Drejtorise Rajonale të Policisë Durrës.

Gjatë këtij takimi u diskutua me Shefin e Seksionit të Policimit në Komunitet, specialisten  si edhe SPZ-të zonës në lidhje me problematikat që hasen në praktikë gjatë zbatimit të ligjit "Për masat ndaj dhunës në familje", ku një ndër problematika kryesore mbetej strehimi i viktimave, por edhe rehabilitimi i dhunuesit.

Punonjësve të Policisë ju bë një prezantim i shkurtër në lidhje me ligjin nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", kushtet, kriteret dhe kategoritë përfituese të këtij ligji. Në këtë aktivitet u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional në mënyrë që viktimat e krimit dhe trafikimit të përfitojnë të gjith të drejtat e parashikuara nga ligjet specifike. Ky takim dhe një efekt të menjëhershëm pasi SPZ-të e zonës shprehën gadishmërinë e tyre për të referuar rastet pranë Qendrës

**Takime në terren në aktivitetin për gratë dhe vajzat në Sheshin Skënderbej, nën emrin "Vrapojmë për Jetën".**

**Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë në bashkëpunim me paraligjoren zhvilluan një takim pranë Qëndrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje në Kamëz.**

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier ka organizuar një aktivitet pranë fasonerisë "Romano Invest" në kuadër të kategorisë së vecantë "Viktima të dhunës në familje". Në këtë takim u dha informacioni duhur ligjor se ato mund të përfitojnë ndihmë juridike parësore, dytësore në bazë të ligjit për ndihmë juridike duke u njohur me të gjithë procedurë e funksionimit të ligjit. Gjithashtu u informuan mbi shërbimet e tjera që ofron qendra mbi cështjet ligjore të natyrave familjare, civile, penale, administrative si dhe u adresuan për vendodhjen e re të zyrës.

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan së bashku me paraligjoren zhvilluan një aktivitet pranë Tregut Rom në qytetin e Elbasanit ku u shpërndanë fletëpalosje dhe u njohën qytetarët me ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", shërbimet që ofron QSHNJP Elbasan.
Më pas u vazhdua me takimet në lagjen 5 Maji në Elbasan, lagje në të cilen banon ky komunitet ku u shpërndanë fletëpalosje, u shpjeguan shërbimet që ofron QSHNJP Elbasan. Ky ishte një takim frytëdhënes sepse pati një interes shumë të lartë nga ana e tyre marë shkas dhe nga problematikat e shumta që ka ky komunitet.

Qendra e Shërbimit të ndihmës juridike Parësore Berat ne datë 27-28 tetor 2022, mori pjesë në ciklin e trajnimeve mbi dhunën me bazë gjinore, në zbatim të projektit "Strehëza", që financohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale (Fondi Social) dhe zbatohet nga Bashkia Berat në partneritet me Society Forward Center.
Ky cikël trajnimesh u prit shumë mirë nga përfituesit, punonjës të shërbimeve sociale shtetërore në shkolla, në bashki, në polici dhe grupet e tjera të interesit në këtë fushë. Të pranishmit u njohën me Ligjin Nr.111/2017 "Për ndihmën Juridike të garantuar nga shteti", kategoritë e vecanta të përfituesve, shërbimet që ofron qëndra ,si dhe vendodhja e qendrës.

BERATI
PËR TË GJITHË PËRMES
NDËRKULTURALIZMIT

KATERINA
FATJONA
ERJOLA

**Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan në bashkëpunim me paraligjoren zhvilluan një fushatë ndërgjegjësimi pranë fasonerisë "Eria Textiles".**

# Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan në bashkëpunim me paraligjoren morën pjesë në aktivitetin “Qasje në shërbimet ligjore për individët në nevojë" zhvilluar nga Fondacioni Joscelyn

**Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Dibër zhvilluan një takim në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Policisë së Shtetit Qarkut Dibër.**

**Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër zhvilluan një takim në bashkëpunim me psikologun në gjimnazin "28 Nëntori" me nxënësit e kësaj shkolle. Nxënësit u informuan mbi ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" lidhur me kategoritë përfituese të ndihmës juridike falas.**